

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në Shkenca Islame

Ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Gjergji Sinani

Prof. As. Dr. Enri Hide



(Maj/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Shkenca Islame

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Beder"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Humane
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 286, datë 6.4.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Shkenca Islame
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (Gjashtë)
16	Numri i Studentëve	57 Studentë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Islame organizohet nga Departamenti i Shkencave Islame. Ky departament është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane në Kolegjin Universitar “Bedër”. Departamenti i Shkencave Islame e realizon veprimtarinë e tij akademike në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, licensën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licensimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë KU “Bedër” (e ndryshuar), Urdhrin me Nr. 534 datë 27.10.2011 “Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të Shkollës së Lartë private KU “Bedër”. Departamenti vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore dhe kontribuon në zhvillimin e studimeve, kërkimit shkencor dhe formimit të të rinjve profesionistë në fushën e shkencave islame. Departamenti, me programet mësimore të ciklit të parë dhe të dytë, promovon edukimin teologjik dhe etik të studentëve, si bazë për deontologjinë e tyre profesionale dhe të sjelljes. Akreditimi i parë institucional është realizuar në vitin 2013 nga APAAL dhe, në vitin 2017, ky vlerësim për programet e studimit të ofruara, është rikonfirmuar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë. Institucioni ka marrë certifikatën e cilësisë ISO 9001:2008. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Islame është akredituar për herë të parë me urdhër nr. 223, datë 4.06.2013.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof.Dr. Gjergji Sinani dhe Prof. As. Dr. Enri Hide, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Draft-Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 13.05.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.6/57 prot. Datë 13.05.2019. Institucioni ka sjellë me anë të shkresës nr. 147/15 prot. Datë 17.05.2019, komentet mbi draft raportin.

GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:


-Për komentin: *RVB sqaron se, duke qënë se KU Bedër është një insitucion jo i madh, ngarkesa në auditorë ku dhe grupet janë relativisht të vogla krijon mundësinë e përballimit të ngarkesës drejtuese. Megjithatë, stafi i ri i përgatitur në auditorët tona, po specializohet në fushën e lëndëve që janë në ngarkim të titullarëve gjë që do të zbusë, që në vitin e ardhshëm raportin e ngarkesës mësimore me punën administrative.* GVJ duke vlerësuar komentin e institucionit, arrin në përfundimin se **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Për komentin: *RVB, sqaron se, silabuset përditësohen cdo fillim semestri, një detyrim ky edhe i sistemit të automatizimit BIS, i cili nuk lejon lektorin të hedhë notat dhe të finalizojë rezultatet përfundimtare.* GVJ arrin në përfundimin se sugjerimi i grupit të punës (GVJ) i referohet standardizimit të silabuseve si format dhe përmbajtje. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

- Për komentin: *Programi Bachelor në Shkenca Islame ka një numër të konsiderueshëm lëndësh me zgjedhje të shpërndara në tre vite, sipas tabelës bashkangjitur.* GVJ, merr në konsideratë komentet e institucionit lidhur me lëndët me zgjedhje, mbështetur edhe në tabelen përkatëse mbi lëndët me zgjedhje sjellë nga institucioni, arrin në përfundimin se në program ka një prani të kënaqshme lëndësh opsionale për studentët, prandaj **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

- Për komentin: *Raporti i këtij programi i përket nivelit Bachelor i cili nuk ka një lidhje direkte me ALUMNI. Megjithatë Departamenti i Shkencave Islame ka një rrjet të konsoliduar të kontakteve me*

ALUMNI, të cilët vijnë nga 13 shtete të ndryshme gjatë viteve 2011-2019, me të cilët departamenti krijon mundësi të herëpashershme të bursave të studimit pasuniversitare si në SHBA, Itali, Austri, Islandë, Turqi, Gjermani, Belgjikë, etj si dhe të punësimit në Shqipëri dhe diasporë. Krahas këtyre me propozim të departamentit, si pjesë e programit ALUMNI, i cili organizohet cdo vit nga IAL është themeluar cmimi 'H. Vehbi Dibra', me motivacionin 'Për kontributin e vyer në arsim, shkencë, art dhe paqe sociale duke përcuar vlera morale, etike dhe universale në shoqërinë shqiptare dhe përtej saj në gjurmet e figurës së ndritur të H.Vehbi Dibrës'. Prej tre vitesh ky cmim i është dhënë të diplomuarve nga ky departament, të cilët aktualisht janë të punësuar si mësues në medrese dhe në institucionet në varësi të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. GVJ njeh dhe pranon përpjekjet e kënaqshme të institucionit lidhur me ALUMNI dhe për këtë arsye, i referohet fuqizimit të mëtejshëm të këtij rrjeti, si një prej prioriteteve që mund të vendosë institucioni në periudhë afatmesme. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të pasurohet biblioteka e Institucionit me literaturë të shkruar në gjuhën shqipe.
- b) Të rritet numri i personelit akademik shqiptar.
- c) Të krijohet një koordinim më i efektshëm ndërmjet departamenteve dhe Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë si për vjeljen e informacionit, ashtu edhe për reflektimin mbi rezultatet e vlerësimit.
- d) Të realizohet një lidhje midis stafit dhe studentëve për të qenë më në korrente rreth problematikave korrente me të cilat përballet bashkësia e myslimanëve që frekuenton xhamitë e vendit.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin *“Të pasurohet biblioteka e Institucionit me literaturë të shkruar në gjuhën shqipe”*, nga vizita ne biblioteke GVJ konstatoi se KUB ka shtuar literaturën në gjuhën shqipe, me botime të ardhura nga KMSH, Fakulteti i Studimeve Islame Prishtinë dhe Fakulteti i Studimeve Islame Shkup, por edhe me botime të tjera. Aktualisht nga 7200 tituj te lidhur me Shkencat Islame, rreth 2160 tituj janë në gjuhën shqipe. **Ky rekomandim është përmbushur.**
- b) Për rekomandimin *“Të rritet numri i personelit akademik shqiptar”*, bazuar ne vizitën në institucion, nga takimi me stafin e programit, GVJ konstaton se institucioni ka shtuar progresivisht personelin akademik shqiptar me kohë të plotë, konkretisht në vitin 2013-2014 ka patur vetëm 1 pedagog shqiptar, numer ky që ka ardhur në rrijte në vitet në vijim , 2 në vitin 2014-2015, 3 në vitin 2015-2016, 7 në vitin 2016-2017 dhe 6 në vitet 2017-2018 dhe 2018-2019. Ky numër pritet që të rritet akoma më shumë në momentin e miratimit nga Ministria e Arsimit të riorganizimit të Departamentit në gjuhën shqipe. **Ky rekomandim është përmbushur.**
- c) Për rekomandimin *“Të krijohet një koordinim më i efektshëm ndërmjet departamenteve dhe Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë si për vjeljen e informacionit, ashtu edhe për reflektimin mbi rezultatet e vlerësimit”*, nga takimi me Përgjigjësin e Departamentit dhe përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ konstaton se ekziston një koordinim dhe bashkëpunim i efektshëm midis Departamentit dhe NJSBC-së ne realizimin e metodave të vlerësimit dhe shqyrtimit të rezultateve të tyre. **Ky rekomandim është përmbushur.**
- d) Për rekomandimin *“Të realizohet një lidhje midis stafit dhe studenteve për të qenë më në korrente rreth problematikave korrente me të cilat përballet bashkësia e myslimanëve që frekuenton xhamitë e vendit!”*, nga takimi me studentet dhe stafin akademik te këtij programi studimi, GVJ konstaton se Departamenti ka bërë përpjekje për përmbushjen e këtij rekomandimi duke organizuar aktivitete të ndryshme si, leksione të hapura seminare informuese ku marrin pjesë studentët dhe personeli akademik, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për problematikat me të cilat haset bashkësia myslimane në xhamitë e vendit. **Ky rekomandim është përmbushur.**

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Departamenti i Shkencave Islame është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane të Kolegjit Universitar “Bedër”, që e realizon veprimtarinë e vet akademike në përputhje me, Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, licensën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licensimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë KU “Bedër” (e ndryshuar), Urdhrin me Nr. 534 datë 27.10.2011 “Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të Shkollës së Lartë private KU “Bedër”. Departamenti i Shkencave Islame vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave islame. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies si dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale e financiare të departamentit.

Departamenti i Shkencave Islame promovon së pari një kuptim të drejtë të islamit, kulturës dhe qytetërimit të tij, duke nxitur mirëkuptimin reciprok midis shtresave të ndryshme të shoqërisë, bashkëjetesën paqësore fetare të tyre dhe duke kontribuar në përhapjen e mesazhit paqësor të Islamit në rajon e më gjerë.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Islame u ofron studentëve njohuri të avancuara dhe aftësi kërkimore në fushën e shkencave islame, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale në fushën e përmbajtjes dhe vlerave të Islamit. Programi synon të edukojë një profesionist të fushës, kërkues, aktiv, bashkëpunues, i integruar në shoqëri, zotëruar i cilësive më të mira etike, estetike, kulturore dhe profesionale, që ka përvetësuar vlerat kombëtare e universale të teologjisë islame. Nëpërmjet programit, studentët fitojnë aftësi të leximit dhe vlerësimit të burimeve klasike e bashkëkohore të Studimeve Islame, edukohen për të përvetësuar njohuri të thella të aspektit fetar e social në fushën e studimeve islame, si dhe përgatiten e formohen duke gërshetuar traditën, kulturën dhe realitetin bashkëkohor.

Nëpërmjet realizimit të objektivave synohet, në mënyrë të veçantë, të ruhet dhe forcohet tradita e një islami shqiptar, kundër influencave të ndryshme të një Islami radikal, në përputhje me kërkesat më imediate të realitetit të kohës. Realizimi i një sërë aktiviteteve jashtëkurrikulare të studentëve, i aktivizimit të tyre në veprimtari sociale dhe kulturore si dhe promovimi i veprimtarisë kërkimore, shkencore e botuese të stafit akademik dhe studentëve janë konceptuar si faktorë të rëndësishëm për të lidhur edhe më mirë objektivat e mësimdhënies me nevojat dhe kërkesat e kohës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në vizitën e zhvilluar pranë institucionit, por edhe në takimet që u zhvilluan me drejtues të departamentit, stafin akademik dhe studentët, si edhe me përfaqësues të zyrave administrative brenda institucionit, rezultojnë se programi Bsc. në Shkenca Islame është në përputhje të plotë me misionin e IAL-së, kjo jo vetëm nga përshkrimi që i bëhet në dokumentacion, por edhe nga mënyra se si ai implementohet.</p> <p>Nëpërmjet shqyrtimit të RVB-së dhe evidencave, vihet re se programi në fjalë shërben për formimin e specialistëve të fushës, të edukuar me aftësi dhe cilësi të leximit dhe perceptimit të burimeve themelore të studimeve islame.</p> <p>Nisur nga kurrikulat dhe përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, rezultojnë se ky program kontribuon në përhapjen e mesazhit paqësor të Islamit në rajon e më gjerë, bazuar dhe në traditën shekullore të shqiptarët.</p> <p>Për më tej, vlen për t'u theksuar se programi Bsc. në Shkenca Islame është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri, i hartuar varësisht nevojave të tregut të punës të paraqitura nga institucioni më i madh religjioz në vend, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Përmes studimit të tregut, ky i fundit ka dëshmuar nevojën për të diplomuar nga kjo fushë studimesh për formim dhe plotësim të kuadrove të vet ne rang kombëtar.</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe me strategjinë e KMSH-së. Institucioni ka kryer një treg pune (studim tregu) i cili pasqyrohet në dosjen e riorganizimit të programit, paraqitur në evidencën nr. 52.</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV dhe konstatimet nga vizitat dhe takimet në institucion rezultojnë se programi është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të MASR. Gjithashtu programi përputhet me politikat e këtij departamenti, siç është dhe promovimi i bashkëjetesës dhe dialogut ndërfaqësor në vend. Në funksion të realizimit të kësaj qasjeje, Departamenti, që nga çelja e tij e deri më sot ka kryer një sërë aktiviteteve periodike në kuadër të promovimit të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqësore, si në bashkëpunim me IAL-të e tjera teologjike në Shqipëri, por edhe simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e dialogut ndërfaqësor.</p> <p>Aktivitetet e Dialogut Ndërfetar në KU "Bedër" (2014-2018), janë paraqitur dhe në evidencën nr. 54 në RVB. Një rëndësi të veçantë departamenti i ka kushtuar edhe botimit të artikujve shkencorë të stafit akademik, por edhe punimet më të mira të studentëve nga projektet dhe pjesë të shkëputura nga tezat e Bachelorit dhe Masterit në Revistën shkencore "Zani i Naltë", organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, themeluar më 1923, kryeredaktor i së cilës është edhe Përgjegjësi i këtij Departamenti (2012 e në vazhdim), si dhe anëtarë të Bordit Shkencor të së cilës janë dhe anëtarë të stafit akademik të Departamentit të Shkencave Islame, si dhe të KU Bedër.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të</p>	

institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe konstatimet nga vizitat dhe takimet në institucion me dekanin dhe përgjegjësën e departamentit, rezulton se programi Bsc Shkenca Islame është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të KUB dhe të Departamentit, me standardet ndërkombëtare, si dhe me veçantitë dhe risitë, që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë, duke evidentuar pikërisht ato risi që lidhen me rifitimin e lirisë së fesë në Shqipëri.</p> <p>Bazuar në RVB, misioni i Departamentit të Shkencave Islame është formimi i një individi, që përmbledh në vetvete cilësitë dhe aftësitë e leximit dhe perceptimit të burimeve themelore të studimeve islame, që ndjek nga afër nevojat dhe ecurinë e informacionit në këtë fushë, kërkues, aktiv, bashkëpunues, i integruar në shoqëri dhe që ka përvetësuar vlerat kombëtare e universale, si dhe zotërues i cilësive etike, estetike, kulturore dhe profesionale.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi Bachelor në Shkenca Islame synon të realizojnë formimin e studentëve në përputhje me synimet strategjike duke plotësuar edhe nevojat e tregut të punës në vend.</p> <p>Institucioni ka realizuar me anën e një grupi pune të ngritur me personel të Departamentit të Shkencave Islame, një studim të tregut të punës. Studimi përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun kombëtar, kërkesat e punëdhënësve etj. siç tregohet në Evidenca nr. 52.</p> <p>Studimi është pjesë e reformimit që do të bëjë për kurrikulat si riorganizim i programit. Një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program departamenti e paraqet me anë të dorëzimit të kuotave, ku për vitin akademik (2018-2019) janë 35. Aktualisht në Shqipëri nuk gjendet institucione simotra të këtij Departamenti.</p> <p>(Evidenca nr. 52: Shkresë për dorëzimin e dosjes për riorganizim të programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame)</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Bsc. në Shkenca Islame është një program i mbështetur në legjislacionin në vend, ligjin për arsimin e lartë dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Programi Bsc. në Shkenca Islame ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Gjithashtu programi përputhet me politikat e këtij departamenti, siç është dhe promovimi i bashkëjetesës dhe dialogut ndërfaqet në vend. Në funksion të realizimit të kësaj qasjeje, Departamenti, që nga çelja e tij e deri më sot ka kryer një sërë aktivitetesh periodike në kuadër të promovimit të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare, si në bashkëpunim me</p>

IAL-të e tjera teologjike në Shqipëri, por edhe simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e dialogut ndërfetar.
Aktivitetet e Dialogut Ndërfetar në KU “Bedër” (2014-2018), janë paraqitur dhe në evidencën nr. 54 në RVB.

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga studimi i raportit të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB), dosjes së DVV si dhe nga konstatimet gjatë vizitës në institucion dhe takimet me drejtuesit, pedagogët dhe studentët si dhe në bazë të analizës së dokumentacionit përkatës mund të evidentohen përfundimet e mëposhtme:

- a. Ky program, me kurrikulën që ofron dhe elementët përbërës të saj, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.
- b. Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
- c. Kurrikula e programit dhe aktivitetet mbështetëse i shërbejnë njohjes, ruajtjes dhe edukimit të traditave dhe ruajtjes së vlerave kulturore të kombit si dhe forcimit të dialogut ndërfetar.
- d. Programi është në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare, duke sjellë dhe risi që lidhen me veçanësinë e fenomenit fetar në Shqipëri.
- e. Programi është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me Kartën e Bolonjës, dhe me kornizat bazë shqiptare të kualifikimit.
- f. Departamenti në hapjen e këtij programi ka mbajtur parasysh strategjinë e KUB duke hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

KUB organizohet në 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. KUB ka në përbërje të tij 6 njësi bazë departamente, dy qendra kërkimore zhvillimore, si edhe njësitë ndihmëse administrative, sipas organigramës së miratuar. Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre.

Fakulteti i Shkencave Humane në Kolegjin Universitar Beder ka në përbërjen e tij këto departamente:

1. Departamenti i Shkencave Islame;
2. Departamenti i Drejtësisë;
3. Departamenti i Shkencave të Komunikimit.

Secili nga departamentet ka stafin e tij akademik, një punonjës të personelit ndihmës akademik dhe një koordinatorë të departamentit. (Aneksë, Tabela nr. 1)

Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane të KUB është organi i lartë ekzekutiv dhe ka në përbërje (1) Dekanin; (2) Zëvendësdekanin; (3) Përgjegjësit e njësive bazë (departamenteve); (4) administratorin e fakultetit; Edhe Dekanati i Fakultetit vepron mbi bazën e rregulloreve të përcaktuara dhe të miratuara. Dekanati mbledhet jo më pak se një herë në muaj. Dekani ka titullin Profesor dhe ka një listë funksionesh / detyrash të përcaktuara.

Departamenti i Shkencave Islame ka programe studimi të nivelit të parë dhe të dytë:

- Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor në shkencë Islame)
- Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave në Shkencë Themelore Islame dhe Master i Shkencave në Shkencë Moderne Islame)

Secili nga Departamentet ka një mision të përcaktuar dhe rregulloret përkatëse. Fakulteti ka rregullore të mirëpërcaktuara për funksionet e tij duke patur të veçante si “Rregulloren mbi organizimin akademik” ashtu edhe “Rregulloren mbi organizimin administrativ”

Departamenti i Shkencave Islame, si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, operon në bazë të parimit të autonomisë, brenda kompetencave përkatëse. Me mision përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e Shkencave Islame, ai i përgatit studentët me njohuri të nivelit bashkëkohor si dhe u krijon kushte për studime të thelluara brenda dhe jashtë vendit. Njësia bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe angazhimin ndërkulturor me programet Bsc dhe Msc.

Bazuar në evidencën nr. 54 dhe 55 shohim që gjatë këtyre viteve akademike, Departamenti u ka kushtuar një rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtëkurrikulare të studentëve, nëpërmjet aktivizimit të tyre në aktivitete sociale dhe kulturore, nëpërmjet klubeve studentore, si dhe simpoziumeve dhe konferencave. Një rëndësi të veçantë departamenti i ka kushtuar edhe botimit të artikujve shkencorë të stafit akademik, por edhe punimeve më të mira të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës
- Staf i akademik për departamentin e Shkencave Islame për vitin akademik 2013-2014 është 11 anëtarë PAE (1 Prof. Dr dhe 2 Dr), si dhe 3 PAK (1 Prof. Dr.)
 - Staf i akademik për programin e studimit Bachelor në Shkencë Islame për vitin akademik 2014-2015 është 11 anëtarë PAE (1 Prof. Dr dhe 4 Dr.), si dhe 2 PAK (1 Dr).
 - Staf i akademik për programin e studimit Bachelor në Shkencë Islame për vitin akademik 2015-2016 është 11 anëtarë PAE (1 Prof. Dr) dhe 5 Dr), si dhe (2 PAK).
 - Staf i akademik për programin e studimit Bachelor në Shkencë Islame për vitin akademik 2016-2017 është 11 anëtarë PAE, (1 Prof. Dr dhe 4 Dr.), si dhe 4 PAK (1 Dr).
 - Staf i akademik për programin e studimit Bachelor në Shkencë Islame për vitin akademik 2017-2018 është 9 anëtarë PAE (4 Dr), si dhe 6 PAK (2 Dr).
 - Staf i akademik për programin e studimit Bachelor në Shkencë Islame për vitin akademik 2018-2019 është 11 anëtarë PAE (1 Prof. Asc. Dr) dhe (4 Dr), si dhe 3 PAK (1 Dr).
- Nga analiza e të dhënave në RVB dhe konstatimeve nga vizita në institucion vihet re se stafi akademik në fillimet e këtij departamenti përbehej nga pedagogë të huaj me tituj dhe grada shkencore, por progresivisht ka ardhur në rritje numri i pedagogëve shqiptarë. Në dy vitet e fundit përgjegjësi i departamentit është shqiptar. Ndërkohë, departamenti ka mundësuar ardhjen e pedagogëve të huaj nga universitetet e Egjiptit, Turqisë dhe Jordanisë. Për më shumë shiko Tabelën 2 në Aneks.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportit PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Rregullorja e KUB (evidenca 2 dhe 3) përcakton politikat për nxitjen e stafit, si të atij me kohë të plotë, ashtu edhe të atij me kohë të pjesshme ose të ftuar. Departamenti i Shkencave Islame ka aplikuar të njëjtat standarde edhe për punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe të atij administrativ, duke synuar edhe promovimin e stafit të ri akademik, si asistentë-lektorë me studentë, që vazhdojnë studimet në ciklin e dytë apo të tretë, të diplomuar nga ky departament, me qëllim angazhimin e tyre në të ardhmen në fushën akademike, duke rritur edhe përqindjen e stafit akademik femër në departament.

Personeli akademik dhe ai administrativ i cili jep mësim në programin Bachelor në Shkenca Islame, sikurse i gjithë personeli i KUB, i rregullon marrëdhëniet e punës mbi kontrata si me Kohë të Plotë dhe me Kohë të Pjesshme, me afat apo pa afat, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Kodit të Punës si edhe rregulloreve të KUB.

Siç është parashtruar edhe në Evidenca nr. 17 për rekrutimin e pedagogëve me kohë të plotë apo të pjesshme, ndiqet një proces i përcaktuar rekrutimi, ku shikoheshin të gjithë elementët, si ata të gradave shkencore, diplomat, aktiviteti kërkimor, përvoja dhe kriteret e tjera të përcaktuara me ligj. Kriteret dhe hapja e vendeve të reja të punës publikohej edhe online në faqen Web të KUB. Departamenti ka rol kryesor në përcaktimin e pedagogëve për programin specifik të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2013-2014 është 13 anëtarë PAE (1 Prof. Dr, 1 Prof As dhe 2 Dr), si dhe 7 PAK (1 Prof. Dr). Raporti PAK/ PAE është 13/7.
- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2014-2015 është 13 anëtarë PAE (1 Prof. Dr, 1 Prof As. dhe 4 Dr), si dhe 4 PAK (1 Dr). Raporti PAK/ PAE është 13/4.
- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2015-2016 është 14 anëtarë PAE (1 Prof. Dr, 1 Prof As. dhe 5 Dr), si dhe 4 PAK, (1 Dr). Raporti PAK/ PAE është 14/4.
- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2016-2017 është 16 anëtarë PAE (1 Prof. Dr, 1 Prof As. dhe 6 Dr), si dhe 4 PAK (1 Dr). Raporti PAK/ PAE është 16/4.
- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2017-2018 është 13 anëtarë PAE, (1 Prof As, 5 Dr), si dhe 5 PAK ,(1 Dr). Raporti PAK/ PAE është 13/5.
- Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Shkenca Islame për vitin akademik 2018-2019 është 11 anëtarë PAE (1 Prof. As. dhe 4 Dr), si dhe 3 PAK (1 Dr). Raporti PAK/ PAE është 11/3. Për më shumë shiko tabelën 3 në Aneks.

Nga analiza e të dhënave vihet re pësha specifike në rritje e stafit PAE dhe PAK me pedagogë shqiptarë, gjë që përputhet edhe me rekomandimet e vlerësimit të parë. (Evidenca shtesë nr. 7).

Duke u bazuar në evidencën shtesë nr. 1 të DVV (Ngarkesa e orëve mësimore të stafit), ngarkesa në orë e personelit akademik sipas raportit orë totale në Bachelor/ orë totale në KUB për vitin 2018-2019, është si më poshtë:

Dr.G.K 98/476, Prof.As. R.O 140/336, Dr. J.A 280/448, Dr. A.D 140/434, Dr. F.U.B 154/336, Dr. H.B 70/294. Pjesa tjetër e stafit akademik rezulton e angazhuar vetëm në këtë program studimi me një minimum prej 48 orësh (Msc.D.D), dhe me një maksimum prej 412 orësh (Msc.E.K).

Programi i studimit Bsc Shkenca Islame në vitet 2013-2014 dhe 2014-2015 është mbuluar në masën mbi 70% nga staf akademik efektiv dhe në vitet 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019 në masën mbi 80 %. GVJ konstatoi dhe se ka pasur një rritje të angazhimit të stafit akademik efektiv (PAE) gjatë periudhës 2016-2019. Gjithashtu rezultoi se institucioni ka bërë edhe një shpërndarje të njëtrajtshme të ngarkesës sipas gradave shkencore. *Megjithatë shtrohet një çështje lidhur me ngarkesat e drejtuesve, si Dekani dhe Përgjegjësi i Departamenti, ngarkesa e lartë e të cilëve mund të rezultojë në ulje të efikasitetit të kryerjes së funksioneve të tyre drejtuese. Rekomandohet rishikimi i këtyre ngarkesave për nivelin drejtues.*

Të dhëna sipas moshës së personelit

Përsa i takon aspektit moshor vihet re një predominim i moshës së re. (Shih tabelën nr. 5 në Aneks).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat.

Zyra e Burimeve Njerëzore është e njohur për të gjithë KUB. Zyra e Burimeve Njerëzore ka kontratat individuale të secilit nga anëtarët e stafit. Ata janë të njohur me detyrat dhe të drejtat e tyre sipas kontratave respektive. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore në KUB u njohem, me metodën e sondimit, kontratat e stafit akademik dhe mbështetës. Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB kishte dosjet me kontratat dhe elementët e tjerë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për secilin nga anëtarët e Departamentit të Shkencave Islame. Kontratat kishin të detajuar si pjesën mësimore, ashtu edhe elementet e tjerë të punës që konvertoheshin si elementë të pagës dhe ngarkesës së punës. Kontratat janë të firmosura nga pedagogu përkatës dhe punëdhënësi. Kontrata ka edhe një aneks kontratë në të cilën përcaktohet vendi i punës, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga njohja me dokumentacionin dhe takimet me këtë staf, konstatohet se programi mbështetet edhe nga një staf i kualifikuar ndihmës/administrativ, me diplomim dhe kualifikime edhe në universitetet e huaja.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Departamenti i Shkencave të Islame, si pjesë e KUB, ndjek procedura dhe aktet ligjore në rekrutimin e personelit në përputhje me (i) Statutin e KUB, (ii) Rregulloren themelore të KUB; (iii) Procedurën e punësimit të personelit. Procesi përzgjedhës për rekrutimin e personeli përfshin aplikimin individual për pozicionet e njoftuara dhe konkursin përzgjedhës.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Sipas statutit të KUB kriteret profesionale të punësimit përcaktohen nga njësi bazë, në këtë rast departamenti. Këto aprovohen nga Dekani dhe Rektori i KUB. Për përzgjedhjen e kandidatëve që do të jenë pedagogë ngrihet një komision i posaçëm me përbërje shumica nga departamenti i cili bën propozimet dhe listimin e aplikantëve të cilin ja përcjell Rektorit për vendimmarrje.
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Pedagoget që japin mësim në programin “Bachelor në Shkenca Islame” në departament janë të punësuar me kontratë si Personel
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	

Akademik Efektiv dhe si Personel Akademik me Kontratë.

Duke krahasuar raportet e ngarkesës mësimore për lëndët e mbuluara nga Personeli Akademik Efektiv të punësuar me kontratë të plotë ndaj personelit akademik total të angazhuar në realizimin e programeve në ciklin e parë, ky raport është ka qenë gjithnjë mbi 70 % dhe për vitet mësimore 2016- 2017, 2017- 2018 dhe 2018-2019 është mbi 80%. Personeli Akademik Efektiv (si numër fizik personeli) në programin e ciklit të parë ka ardhur duke u rritur dhe duke marrë më shumë ngarkesë mësimore nga viti në vit.

Institucioni ndjek procedura ligjore e transparente për vlerësimin e personelit akademik. Vlerësimi i personelit bazohet në një kombinim të komponentëve që përfshijnë: vlerësimin nga ana e studentëve për lektorët e lëndëve, vetëvlerësimin, dhe vlerësimin e eprorit të njësisë për secilin nga anëtarët e stafit. Vlerësimi i studentëve për lektorët e lëndëve bëhet nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri para provimeve finale, ku studentët kanë mundësi të vlerësojnë elementët e detajuar që lidhen me performancën e stafit. Më pas rezultatet përpunohen në formë elektronike nga sistemi. Procedura është e parashikuar në Rregulloren për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit. Po kështu, bazuar në formularin e vetëvlerësimit të stafit akademik, që plotësohet nga secili anëtar, në fund të vitit akademik, eprori i njësisë ka mundësi të bëjë vlerësimin mbi vetëdeklarimet e personelit dhe rezultatin e arritur.

Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB mban një bazë të dhënash për personelin akademik në fazën e rekrutimit, e cila përditësohet në vazhdimësi sipas kërkesave ligjore dhe ndryshimeve që vetë personeli ka në jetën e tij akademike dhe profesionale. Kjo zyrë mban në një dosje të veçantë njoftimet e punësimit apo kërkesat për staf të ri akademik të ardhura nga departamentet. Njoftimet e punësimit, krahas publikimit në hapësirat e vetë universitetit, në faqen e tij të internetit dhe kanalet e tjera të informimit në mediat sociale, i dërgohen edhe Drejtorisë Rajonale të Punësimit. Institucioni u ofron mundësinë e aplikimit online personave që janë të interesuar për t'u punësuar pranë këtij institucioni si personel akademik efektiv. Institucioni mban një bazë të dhënash të marrjes në punë, duke krijuar edhe dosjet e stafit të punësuar dhe atij të larguar, si edhe të gjitha njoftimet e publikuara për marrjen në punë.

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë

Gjatë vizitës në institucion dhe në zyrën e Burimeve Njerëzore vihet re se Institucioni, për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë me angazhim të pjesshëm, ka të plotësuar e arkivuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga zyra e punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar dhe të përditësuara. Në fund të çdo viti bëhet edhe mbledhja e të gjithë angazhimit kërkimor-shkencor për secilin, që pasqyrohet edhe në raportin vjetor të aktiviteteve.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, evidencave dhe bisedimeve me krerët e zyrave vumë re se Institucioni disponon një listë të plotë të stafit akademik, ndihmës mësimor-shkencor e administrativ. Gjithashtu edhe zyra e Burimeve Njerëzore në KUB

<p>të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor., ose titullin akademik "Docent.,,</p>	<p>ka dosje të veçanta për çdo pedagog duke krijuar një bazë të rëndësishme të dhënash.</p> <p>Institucioni, në çdo rast rekrutimi të personelit akademik, është bazuar tek Ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Institucioni disponon praktikatat e dokumentuara me shkrim mbi kriteret e ndjekura për këtë qëllim. Këto kritere janë të reflektuara edhe në njoftimin e punësimit të bërë nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Titullarët e lëndëve janë të gjithë me gradën shkencore Dr. dhe asistent lektorët janë me kualifikim Doktorant dhe Msc.</p>
---	---

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame, është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane në KUB. Ai ndan së bashku me departamentet e tjera në KUB personelin ndihmës mësimor –shkencor dhe ambientet të tilla si bibliotekën, sekretariatë kryesore, zyrën e kërkimit shkencor dhe zyrën e projekteve.</p> <p>I gjithë personeli i këtyre zyrave ndihmon studentët e programit të ciklit të parë për të realizuar detyrat, zhvillimin e rregullt të praktikave mësimore, marrjen e informacionit të nevojshëm dhe komunikimin efektiv në shërbim të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni ka ngritur një qendër praktike ku studentët bëjnë praktikën e lëndës së predikimit fetar e cila përfshin ligjëratat javore dhe aftësimin profesional të tyre.</p> <p>Angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës synon përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si me punën brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit.</p> <p>Departamenti ofron për studentët edhe këshilltarë akademikë si një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve. Ata janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh</p> <p>Programi Bachelor në Shkenca Islame ka të përfshirë si anën teorike të zhvilluar në ambientet e KUB ashtu edhe atë praktike. KUB ka Zyrën e Planifikimit të Karrierës, ku çdo fillim viti departamenti përcakton një përfaqësues të tij në këtë zyrë. Po kështu në programin mësimor është edhe lënda e Praktikës Profesionale, ku studentët ndahen në grupe nën drejtimin e disa pedagogëve dhe varësisht interesit të tyre zhvillojnë praktikë. Raporti aktual pedagog/studentë në këtë lëndë është rreth 1 me 4.</p>
--	--

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë dy pjesë shumë të rëndësishme të strukturës organizative në KUB. Siç shohim edhe në evidencën nr. 32 ato përgatisin plan lidhur me trajnimet e domosdoshme për personelin.</p> <p>Trajnimet pasqyrohen edhe në faqen web tek NJSBC, www.qac.beder.edu.al.</p>
--	---

Temat e trajnimeve përcaktohen në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame (dhe njësitë e tjera të ndryshme sipas nevojave specifike). Zyra e Burimeve Njerëzore përmes një e-mail zyrtar njofton të gjithë anëtarët e personelit për të tematikat e trajnimeve dhe fton për pjesëmarrje.

KUB disponon bazë të dhënash për të gjitha programet e ofruara duke i mbajtur ato në dy forma, si atë të printuar ashtu edhe në formë dixhitale, të cilat përditësohen vazhdimisht.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, në konstatimet gjatë vizitave dhe diskutimeve me stafin akademik dhe studentët, rezulton se.

- a. KUB ka një grup rregulloresh që udhëheqin veprimtarinë e stafit. Kjo siguron që procedurat të zbatohen dhe të ketë një menaxhim efektiv të tyre. Departamenti në kuadër të KUB ka bërë përpjekje për rritje profesionale me pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe projekte të ndryshme. Edhe raportet me tituj dhe grada që stafi ka dhe ndryshimi pozitiv i tyre në rritje të vazhdueshme është tregues i kësaj.
- b. Duke krahasuar CV e PAE për programin e studimit dhe lëndët që ata kanë, vihet re një përshtatje e mirë midis tyre. Departamenti ka konsoliduar një praktikë pozitive në përfshirjen e stafit akademik për hartimin dhe ndryshimet në kurrikulat, bazuar edhe në trajnime përkatëse, shkëmbimin e përvojës brenda stafit si dhe sugjerimeve të studentëve.
- c. Rekrutimi i personelit të ri si dhe vlerësimi i tij bëhet në bazë procedurash ligjore dhe transparente, në përputhje me statutin dhe rregulloren.
- d. Stafit akademik, me gradat dhe titujt shkencorë që disponon, i mbulon nevojat e programit por edhe vazhdon procesin e kualifikimeve të mëtejshme, në përputhje me synimet e këtij departamenti.
- e. *Sugjerohet rishikimi i ngarkesës mësimore për nivelin drejtues, për t'u krijuar hapësirën e nevojshme të rritjes së efikasitetit të punës së tyre në nivel drejtues.*
- f. Komunikimi nëpërmjet sistemit të brendshëm online është një mekanizëm mjaft i mirë për të shpërndarë informacionin dhe për ta bërë atë sa më transparent.
- g. Personeli administrativ është mbështetës i atij akademik dhe i shërben arritjes së objektivave të programeve mësimore të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Islame.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga vizita ne institucion dhe shqyrtimi i DVV konstatojmë se Kolegji Universitar Bedër kryen veprimtaritë e tij në dy godina. Të dyja godinat janë të marra me qera me një sipërfaqe totale 5628 m².

Godina A, është një godinë me tetë kate dhe sipërfaqe 3957 m². Në godinën A ka si klasa mësimore ashtu edhe zyra administrative për fakultetet e departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Godina B, është një godinë me dy kate dhe

sipërfaqe 1671 m2. Në godinën B zhvillohen mësim nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

Godinat ofrojnë si pajisje teknike ashtu edhe komoditet për studentët dhe pedagoget. Sallat e mësimi kanë kondicionerë. Në mjaft nga klasat ka “smart tabela” që krijojnë mundësi për interaktivitet në mësimdhënie. Gjithashtu ka edhe videoprojektorë.

Në katin 0 dhe -1 të godinës A, ndodhet edhe Biblioteka, muzeu i medias, salla e gjyqit të improvizuar dhe laborator i informatikës.

Biblioteka ka një klasifikim të librave sipas Bibliotekës së Kongresit. Ajo ofron libra për studentët si në gjuhën shqip ashtu edhe në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht e turqisht. Ndërkohë në bibliotekë funksionon edhe një kompjuter i sistemit të kërkimit online, ku studentet mund të downloadojnë libra të ndryshëm.

Nga vizita në Bibliotekën u informuam se shtimi me tituj të rinj të fondit bëhet përmes:

- Blerjeve të teksteve universitare dhe librave të reja, që janë pjesë e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar;
- Porositë dhe blerjet online për botime periodike shkencore, etj.
- Dhurimi që bëjnë organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione.

Në godinën B, krahas klasave dhe zyrave, ka edhe ambiente për veprimtari ekstra-kurrikulare. Aty ndodhet palestra, që studentët dhe personeli mund ta shfrytëzojnë për aktivitete individuale sportive. Godinat e mësipërme janë të pajisura me mjetet për mbrojtjen kundër zjarrit, si edhe shkallët e emergjencës si dhe e pajisur me sistem ngrohje. KUB ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogjenerator), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji). KUB ka ambiente hidrosanitare në çdo kat, rreth 47 bokse hidro-sanitare për studentët dhe personelin. KUB, për vetë arkitekturën që ka ofron mundësinë e ndriçimit natyral.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit(Tabela nr. 6)

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin. (Tabela nr. 6)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

KUB ka një infrastrukturë të organizuar mirë dhe me mjaft mjedise të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij dhe arritjen e synimeve të programit të studimit. Si nga dosja e vlerësimit të brendshëm ashtu edhe nga vëzhgimet në institucion, u vu re një mjedis cilësor dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit. Sallat e leksioneve dhe sallat e seminareve përmbushin nevojat e studentëve dhe pedagogëve në KUB dhe specifikisht në Departamentin e Shkencave Islame. Gjithashtu në shërbim të studentëve janë edhe ambiente të pajisura me Internet dhe shërbime mbështetëse si fotokopja, salla e bibliotekës etj.

Mjediset e detajuara jepen në Aneksë Tabelat 6. Sipas numrit aktual të studentëve në KUB institucioni ofron rreth 8.1 m²/student. (nga 2.5 m²/student që është normativa shtetërore)

Grupi i vlerësimit të jashtëm i vizitoi të gjithë ambientet që janë në shërbim të studentëve të programit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Bazuar në vizitën e zhvilluar në bibliotekë bisedave me përgjegjësen e saj, vihet re dhe konstatohet se institucioni ka një bibliotekë të pasur me literaturë islame, e vlefshme për departamentin e Shkencave Islame, ku i vihet në dispozicion studentëve një numër i konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literaturë ndihmëse. Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara të programit, bëhet e ditur, që në fillim të semestrit nëpërmjet syllabuseve që gjenden online në faqen e KUB (www.isc.beder.edu.al). Pedagogët përkatës të lëndëve kërkojnë nga departamenti sigurimin në bibliotekë, të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të këtij programi. Shërbimi bibliotekar kryhet prej punonjësve të specializuar. Biblioteka është në hyrje të ndërtesës së institucionit, në katin e parë dhe ka një sipërfaqe prej 230 metra². Ajo ka sallë leximi, me një kapacitet prej 56 vendesh. Biblioteka ka një fond prej rreth 36.000 libra (evidenca nr. 36), ku një vend të rëndësishëm zë literatura islame, e inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe tematikës, si dhe ato gjenden në disa gjuhë të ndryshme si: shqip, anglisht, arabisht, turqisht, etj.</p> <p>Biblioteka e KUB është e pasur me tituj të shumtë në funksion edhe të programit Bachelor në Shkenca Islame, që shërbejnë për realizimin e projekteve kërkimore dhe hartimin e tezave. Pedagogët rekomandojnë literaturë të disponueshme në bibliotekë, sipas syllabuseve e lëndëve të kurrikulës. Sipas konstatimeve gjatë vizitës në bibliotekë, një tjetër mundësi është edhe Biblioteka online Ebsco Host, ku studentët kanë akses në 45.000 libra. Gjithashtu Biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë, u konstatua se në funksion të bibliotekës, KUB ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e</p>

	<p>literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike. Kështu biblioteka ofron sigurimin e materialeve në rrugë elektronike, e cila mundësohet nga abonimi, që është bërë në bibliotekën online Ebsco Host, ku studentët kanë akses jo vetëm në 45.000 libra, por edhe në 5.000 revista të ndryshme ndërkombëtare.</p> <p>Bazuar në projektin buxhetin e vitit 2018-2019 të Departamentit të Shkencave Islame, në bazë të kërkesave specifike i është akorduar një fond i caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës. Ky fond është 1400 euro i cili mundësohet nga zyrat përgjegjëse në Institucion si zyra e financës dhe zyra e administratorit të KUB.</p> <p>Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Biblioteka është e disponueshme nga ora 08:30 deri në orën 19:00. Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në bibliotekë, në sezon provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, u vu re se oraret e bibliotekës janë mëse të mjaftueshme për studim.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, rezultoi se KUB ka mjaftueshëm laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një proces mësimor sa më efektiv, si sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, dërrasë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike, etj., të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes dhe realizimit të programit Bachelor në Shkencat Islame. Laboratorët shërbejnë për praktika profesionale, si recitim Kur'ani dhe shërbime fetare.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si dërrasë interaktive, projektorë, kompjuter, internet etj. Të gjitha mjediset mësimore, janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm. Të gjithë këto komponentë lehtësojnë dhe ndihmojnë në realizimin e zhvillimit me metoda moderne dhe bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>Programet e ofruara në Fakultetin e Shkencave Humane, për vetë natyrën e tij, nuk kanë nevojë për laboratorë eksperimentimi. Për një mësimdhënie sa më efektive, studentët kanë në dispozicion programe kompjuterike të licensuara, si Windows, MS Office, Adobe etj.</p> <p>Departamenti i Shkencave Islame u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme ku studentët zhvillojnë këto praktika. Studentët e këtij departamenti ushtrojnë praktikatat e tyre profesionale në medresetë e</p>
---	--

Shqipërisë që janë institucione në varësi të KMSH-së si dhe në institucione jashtë Shqipërisë (Evidencat 31 dhe 35).

Konkluzione të GVJ:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe nga takimet në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Kolegji Universitar “Bedër” ka një vendndodhje të favorshme dhe një mjedis qëndror administrativ, si dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore, të gjitha bashkëkohorë dhe të plotësuar me të gjitha kushtet.
- b. Në institucion sigurohen tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse e mjaftueshme dhe bashkëkohore. Biblioteka ka një fond të pasur me libra për programet përkatëse. Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike. Përgjegjësi i programit ka hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.
- c. Në institucion ka në numër të mjaftueshëm laboratorë, klasa, zyra, studio dhe salla me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Duke qenë një IAL privat dhe jo fitimprurës, Kolegji Universitar Bedër, pjesën më të madhe të të ardhurave në buxhetin e vet e krijon nga pagesat që vijnë nga studentët që ndjekin studimet, si dhe nga donacionet. Këto të fundit bëhen pjesë e buxhetit bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

KUB procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi. (Aneksë ,Tabela 7)

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, rezidencat, etj)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik .(Aneksë ,Tabela 7)

Grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës në institucion u njoh dhe me dokumentacionin mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, duke evidentuar se të dhënat që paraqiten në materialin e vlerësimit të brendshëm përputhen, si për treguesit e të ardhurave dhe financimeve të ndryshme në 6 vitet e fundit, ashtu dhe për shpenzimet po në këtë periudhë.

Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KUB realizon auditime të brendshme dhe të jashtme për vlerësimin e situatës financiare dhe menaxhimi financiar është nën kontrollin e Fondacionit “Hafiz Ali Korça”, pjesë e të cilit është Kolegji. Raportet financiare hartohen bazuar në legjislacionin në fuqi, duke respektuar afatet, dhe duke pasqyruar detajisht të ardhurat dhe shpenzimet që kryen.</p> <p>Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me raportime të natyrës financiare, si dhe të auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Aty janë përfshirë pjesa e të ardhurave, siç janë ato nga tarifat e studimit të studentëve, nga donacionet vendase apo të huaja, të ardhura nga pjesëmarrja në projekte të ndryshme si konsulenca etj. Gjithashtu përfshihen dhe pjesa e shpenzimeve të realizuara për funksionalitetin e KUB, apo dhe zëri i buxhetit për bursat e akorduara si mbështetje për studentë të ndryshëm.</p> <p>KUB me statusin e një IAL-je jofitimprurëse procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Në mënyrë të përvitshme KUB harton raportin financiar nga një kontabilist i miratuar, dokument që përfshin zërat e të ardhurave, duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi për nivelin e parë, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit, nga konsulenca të ndryshme etj. Gjithashtu dokumenti përmban të detajuar dhe zërat e shpenzimeve që kryen, si ato në formën e pagave dhe honorareve për mësimdhënien, apo dhe shpenzime të tjera administrative e operative në funksionalitetin e të gjithë institucionit.</p> <p>Ky dokument arkivohet pranë fondacionit dhe KUB, sic e përmendëm më sipër bazohet në procesin e raportimit financiar tek kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.</p> <p>KUB respekton dhe afatin e raportimit për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke e kryer cdo fundviti. Pjesë e këtij raportimi është dhe buxheti për vitin që ka kaluar, projeksioni për buxhetin e vitit të ri, si dhe projektbuxheti afatmesëm.</p>

Gjatë njohjes së dokumentacionit mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit grupi i ekspertëve të jashtëm vërejtë qëndrueshmëri në realizimin e këtij programi studimi, duke krijuar mendimin se KUB ka kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur këtë trend edhe për kohën vijuese, në favor të përmirësimit të situatës financiare në institucion dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe takimeve në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Në përputhje me detyrimet ligjore dhe nënligjore në fund të çdo viti institucioni përgatit një raport financiar për të gjitha njësitë akademike dhe administrative. Raporti përmban një pasqyrë të grandeve të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit studimor të ciklit të dytë.
- b. Në raportin e fundvitit analizohet efienca e përdorimit të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. Raporti përgatitet brenda afateve të përcaktuara nga ligji, duke vlerësuar veprimtarinë e deritanishme.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar dhe Statutin e vetë institucionit. Funksionimi i tërësisë së mekanizmave të sistemit të brendshëm të cilësisë rregullohet përmes një kuadri rregullator dhe sidomos themelor është Udhëzuesi i Cilësisë. Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë janë: “Komisioni i përhershëm i garantimit të standardeve të cilësisë institucionale” dhe “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Bazuar në Statutin e institucionit, këto dy struktura gëzojnë autonomi operative dhe akses të plotë në të dhënat mësimore dhe shkencore. Raportet e vazhdueshme që krijon kjo njësi bëhen në nivel semestral dhe vjetor. Një burim tjetër të dhënash që përbëjnë bazën e punës së kësaj njësie janë edhe anketat online nga studentët, të cilat kryhen përpara provimeve semestrale dhe përpara përfundimit të vitit akademik.

Ndër kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë radhiten: mbështetja e Komisionit të Përhershëm (aktet e të cilëve i dërgohen për miratim Senatit Akademik); vlerësimi i veprimtarive mësimore dhe kërkimore të njësisë; ndërmarrja e studimeve mbi ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të institucionit; raportimi pranë Senatit për rezultatet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Anketat me studentët bëhen për çdo lëndë, ato zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri. Gjithsej, për një periudhë gjashtë vjeçare janë zhvilluar 12 anketime të tilla me studentë. Anketimet grumbullohen dhe përpunohen. Ato nxjerrin në pah vlerësimin e metodave të mësimdhënies, bazuar në të cilat departamentet dhe përgjegjësit e tyre bashkë me lektorët, marrin masa për përmirësimin e metodave dhe proceseve të tjera.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë zhvillohet nga dy strukturat përkatëse të ngritura nga institucioni, të emërtuara “Komisioni i përhershëm i garantimit të standardeve të cilësisë institucionale” dhe “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Ai ndërthur gjithashtu të dhëna individuale të punës akademike, administrative dhe shkencore, me të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët e studentëve, në mënyrë periodike. Përveç tyre, ekzistojnë edhe komisionet e posaçme (ad-hoc), të ngritura me urdhër të rektorit (si psh Evidenca Nr. 64, DVV). Këto mekanizma vlerësojnë periodikisht performancën e komponentëve të ndryshëm të brendshëm dhe identifikojnë rrugët për përmirësimin e punës. Përveç të tjerave, të cilat janë shpjeguar dhe më sipër, Institucioni realizon dhe një anketë vjetore me pjesëmarrjen e të gjithëve (personelit akademik, studentëve dhe stafit administrativ) për cilësinë e shërbimeve dhe përmirësimin e tij. (Dokumentacioni i politikës së vlerësimit, Formular i vlerësimit të studentëve për pedagogun dhe lëndën).

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Tabela 8 në Ankese)

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Rezultoni se institucioni ka kryer në mënyrë periodike vetëvlerësime, nëpërmjet studentëve, stafit akademik, atij administrativ dhe vetë strukturave të vlerësimit të brendshëm. Këto vlerësime kryhen një herë në vit (për NJSBC dhe Komisionin) dhe dy herë në vit (një herë në semestër) për studentët. Bazuar në rezultatet e vlerësimeve periodike të formave të ndryshme të vetëvlerësimit bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim, ose zhvillim të mëtejshëm sipas njësive përgjegjëse, pasuar nga një auditim i ri i një komisioni të ngritur posaçërisht. (Raporte të vlerësimit të brendshëm, Raporte të vlerësimit të studentëve)

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Hapat e mëtejshëm, përveç diskutimit me pedagogët individualë, lidhen edhe me ndërmarrjen e trajnimeve për zhvillimin profesional të stafit. Një tjetër metodë për të përmirësuar funksionimin e njësive bazë administrative dhe shkencore, janë diskutimet e hapura të raporteve të vetëvlerësimit me personel akademik dhe administrativ.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologjinë vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologjinë vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, rezultoni se institucioni përdor një sërë instrumentesh matëse dhe vlerësuese: formular për studentët për vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut; raporte periodike të Komisionit dhe NJSBC-së; raporte vetëvlerësimi për Rektorin.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;	
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	

<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>Institucioni i publikon rregullisht rezultatet e vlerësimit dhe objektivat e cilësisë në faqen zyrtare të internetit, në një rubrikë të veçantë. Institucioni ka publikuar në mënyrë transparente dokumentin e politikës së vlerësimit. Institucioni gjithashtu rezulton se ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre. Ai ka publikuar rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit në faqen e internetit të tij. Përsa u përket rezultateve të pritshme, institucioni ka bërë publik planin strategjik institucional 2012-2017 dhe planin e ri strategjik 2018-2023.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar një ndërthurje metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit, të brendshëm, me mekanizma të shumëfishtë vlerësimi për studentët, universitetin, dhe monitorim të mësimdhënies në auditor.</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vot dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Për më tepër, institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve. Institucioni ka përdorur një sërë mekanizmesh formale, jo vetëm cilësorë por edhe sasiorë, përfshirë monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin e studentëve për çdo lëndë, feedback-un nga pedagogët dhe studentët për çdo lëndë, pyetësorë, rezultatet e provimeve, vëzhgime të praktikës, etj. Është verifikuar se të gjitha këto procedura janë pasqyruar në raportin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë verifikuar nga GVJ përveç RVB-së edhe nëpërmjet takimeve me personelin akademik, studentët dhe stafin administrativ të institucionit.</p> <p>Të dhënat e përpunuara janë publikuar çdo herë në faqen e internetit të institucionit, duke rritur transparencën e procesit.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studmi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe takimeve në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë.
- b. Institucioni përdor mekanizmat e duhur formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit në shqyrtim.
- c. Institucioni i bën me dije studentëve dhe palëve të tjera rezultatet e procesit të vlerësimit dhe të garantimit të cilësisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi Bachelor në Shkenca Islame strehohet brenda Departamentit të Shkencave Islame, që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane të KUB. Ky program ka filluar në vitin akademik 2013-2014 dhe zhvillohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu në këtë bazë funksionon licenca e dhënë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licensimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë KUB (e ndryshuar), Urdhrin me Nr. 534 datë 27.10.2011 “Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të ciklit të parë “Bachelor” Shkollës së Lartë private KUB.

Bazuar në RVB dhe dokumentet e tjera mbështetëse, konstatohet se ky program studimi (Bachelor në Shkenca Islame) fokusohet në formimin fetar (Islam) të individëve, duke pasuruar informacionet e tyre fetare duke i integruar ato nga pikëpamja kulturore, kërkimore dhe shkencore me vlera të tjera kombëtare dhe universale. Objektivat e programit përfshijnë gjithashtu ndërtimin e një grupi njohurish rreth çështjeve të administrimit fetar (por edhe atij publik), për të aftësuar studentët mbi praktikatat më të mira dhe të reja të shërbimeve fetare. Synime të tjera lidhen me promovimin e kuptimit më të plotë të fesë Islame, qytetërimit Islam, përhapja e mesazheve të paqes në rajon e më gjerë (nëpërmjet numrit të konsiderueshëm të studentëve nga rajoni), kontributi në një shoqëri demokratike, përgatitja e klerit Islam për të punuar në fushën e shërbimeve fetare, etj.

Organizimi i vitit arsimor bëhet në dy semestra (ku çdo semestër ka 16 javë mësimore), me 32 javë mësimore në total, 180 ECTS, të shpërndara në mënyrë jo plotësisht uniforme nëpër 6 semestra ose tre vite. Sistemi i ECTS parashikon që çdo kredit të jetë 25 orë mësimore, ndërsa një orë mësimore është 50 minuta. Cikli i këtij programi studimor zgjat tre vite dhe synon t’u ofrojë studentë thellimin intelektual, konceptual dhe teorik në Studime Islame.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Programi ka filluar të funksionojë që prej vitit akademik 2013-2014, bazuar në VKM Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licensimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë KUB; dhe Urdhrin Nr. 534 datë 27.10.2011 “Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të ciklit të parë “Bachelor” Shkollës së Lartë private KUB.

Bazuar në RVB, konstatohet se programi i studimit në fjalë, ka këto objektiva:

- studentët të pajisjen me njohuritë themelore të parimeve të përgjithshme në Studimet Islame;
- të njihen me rolin dhe rëndësinë e fesë dhe interpretimin e saj;
- krijimi i bazave studimore për të vijuar studimet në nivelet më të larta pasuniversitare;
- aftësimin e mendimit kritik rreth debateve mbi fenë islame;
- përgatitjen e klerikëve myslimanë shqiptarë;
- fuqizimin e bashkëjetesës fetare.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS ka 25 orë pune në auditor
- 1 orë mësimore është 50 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Plani mësimor për programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Islame, gjendet në shtojcën bashkangjitur, së bashku me syllabuset e lëndëve përkatëse. (Ankese Tabela nr 9).

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 2048 orë në auditor dhe 1498 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 72 orë në auditor dhe 882 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara.

(Anekse, Tabela nr. 11 “Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara”.)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës.

(Anekse, Tabela nr.12)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së silabuseve

Nga këqyrja e syllabuseve të dorëzuar nga institucioni në mënyrë elektronike, por edhe nga vizita në institucion, rezulton që këto dokumente janë të plota dhe se ato përfshijnë parametrat kryesorë, si

emërtimin, semestrin dhe vitin, emrin e pedagogut, vendin që zë lënda, njohuritë paraprake të studentëve, temat, ngarkesën, format e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe literaturën. Silabuset ofrohen në fillim të çdo semestri akademik dhe ato përditësohen në mënyrë periodike nga pedagogët, të cilët e kanë këtë detyrim edhe në formë elektronike (pasi sistemi nuk i lejon të aksesojnë elektronikisht lëndën nëse nuk i kanë përditësuar më parë silabuset). Gjithashtu ato janë objekt i NJSBC-së dhe kontroleve nga përgjegjësi i departamentit. Syllabuset janë përditësuar edhe nga pikëpamja e literaturës, duke përfshirë literaturë bashkëkohore dhe në gjuhën shqipe, përveç asaj në gjuhë të tjera të huaja (arabisht, turqisht, anglisht, etj.).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programin e Bachelor-it në Shkenca Islame në përputhje me kriteret ligjore. Objektivat e programit janë të qarta, ashtu si dhe roli dhe kontributi i këtij programi jo vetëm në raport me studentët por edhe me institucionet e tjera shoqërore.</p> <p>Sistemi i krediteve të përdorura është në përputhje të plotë me atë evropian (ECTS) (bazuar në RVB). Përlllogaritjet e tyre janë të sakta dhe përkojnë me kriteret ligjore. Ka pasur vetëm një numër të vogël ndryshimesh lëndore, të cilat përputhen me nevojat e institucionit për t'u përmirësuar dhe përshtatur me kushtet e ligjore.</p> <p>Siç rezulton nga diskutimi me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik, kreditet janë shpërndarë në mënyrë jo-uniforme nëpër të treja vitet, ndonëse është rreth 60 ECTS (kjo vërtetohet edhe nga këqyrja e programit të studimit, RVB). Totali i nevojshëm për diplomim është 180. Megjithatë kjo është logjike, për shkak të ngarkesës së ndryshme në vitin e tretë me punimin e diplomës.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Njësitë kryesore përgjegjëse për programin, i cili është i ciklit të parë, janë Përgjegjësi i departamentit dhe departamenti, fakulteti dhe njësitë e tjera ndihmëse (NJSBC, Komisioni i Cilësisë, stafi administrativ etj.). Informacioni për programin është i plotë dhe transparent.</p> <p>Ndarja e lëndëve në ato me zgjedhje dhe të detyruara për çdo semestër është e qartë. Kjo qartësi rezultoi edhe gjatë takimit në institucion me studentët, të cilët rezultuan të mire informuar lidhur me mundësitë e zgjedhjeve.</p> <p>Informacioni shpërndahet në mënyrë elektronike (faqja e internetit e personalizuar për çdo student por edhe e institucionit si i tërë) dhe nëpërmjet departamenteve dhe stafit administrativ mbështetës dhe akademik.</p> <p>Gjithashtu institucioni garanton informacion të plotë dhe transparent rreth ngarkesës mësimore, orëve në auditor, frekuentueshmërisë dhe produktit final akademik/shkencor të programit. Në program ka një prani të kënaqshme lëndësh</p>

	opsionale për studentët. Syllabuset janë të detajuara dhe të strukturuar sipas kriterëve të larta të cilësisë, duke ofruar informacion të plotë për numrin e krediteve, përmbajtjen, programin e çdo jave, literaturën e detyruar dhe të sugjeruar, mënyrën e vlerësimit, etj.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe takimeve në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Programi mësimor për këtë Bachelor është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet përkatëse. Informacioni që u ofrohet studentëve për programin është i plotë dhe transparent. Syllabuset janë të përditësuara dhe përmbushin të gjitha kriteret e cilësisë, përfshirë edhe literaturën. 	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion (përfshirë edhe takimet me stafin akademik dhe studentët), rezultojnë se institucioni ka siguruar implementimin e përpiktë të planeve mësimore. Ngarkesat përcaktohen në fillim të çdo semestri ndërsa ekziston edhe një mekanizëm i mirë-koordinuar në nivel institucional për kontrollin dhe përmirësimin e programeve. Format e mësimdhënies janë bashkëkohore dhe të qarta në programet lëndore (Syllabuset), përfshirë leksione, seminare, detyra kurse, praktika, leksione të hapura, etj. Kontrolli i studentëve është transparent dhe i paraqitur qartë që në fillim të vitit/semestrit. Ai u mundëson edhe studentëve mundësinë të ballafaqohen me punën e tyre. Gjithashtu institucioni ka ngritur mekanizma të vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies, përmes një sërë instrumentesh, përfshirë praninë së përgjegjësit të departamentit dhe rektorit në leksione, kontrollin të syllabuseve, etj. Studentët, siç rezultoi jo vetëm nga RVB por edhe nga diskutimet me ta gjatë intervistave të zhvilluara në vizitën në institucion, janë përfshirë në shumë mënyra në proceset akademike (jo vetëm nëpër leksione/seminare), përfshirë edhe konferenca shkencore studentore.

Vlerësimi i studentëve nuk është uniform (në shpërndarjen e pikëve), por ndryshon në varësi të lëndëve. Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme e shpërndarë gjatë gjithë semestrit dhe vitit akademik, duke u krijuar mundësinë studentëve që të jenë pjesë integruese dhe aktive gjatë realizimit të lëndëve mësimore. Megjithatë të gjitha lëndët përfshijnë në vlerësim një sërë komponentësh, si pjesëmarrjen/aktivizimin, provim të ndërmjetëm, ese (punim), provim përfundimtar. Theksohet se vlerësimi është tejet transparent dhe duke ruajtur konfidencialitetin ai është i aksesueshëm individualisht për studentët në formë elektronike (online). Format e kontrollit dhe vlerësimit (ECTS dhe notë) për secilën lëndë ju bëhen të qarta studentëve në fillim të semestrit përkatës. Kjo rezultojnë gjithashtu edhe nga këqyrja e regjistrave të lëndëve, pas vizitës në institucion. Mësimdhënia është interaktive dhe karakterizohet nga përdorimi i teknologjisë së lartë. Ndërkohë që të gjitha janë pjesë e Rregullores (e vendosur në dispozicion të GVJ-së) të Studimeve për Ciklin e Parë dhe të Provimeve.

Ngarkesa mësimore bazohet në udhëzimet e MASR dhe Ligjit të Arsimit të Lartë (9741/2007). Përveç syllabusit, çdo pedagog ka literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, si dhe përgatit dosjen e lëndës, me materialet dhe leksionet e të gjithë semestrit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela nr. 14 në Aneks):

Orët gjithsej në auditor

• Leksione	2048
• Seminare	-
• Ushtrime	-
• Laboratore	-
• Detyra	-
• Praktikë lëndore	-
• Praktikë profesionale	-
• Etj	2452
Gjithsej	4500

- Format e kontrollit të njohurive

Institucioni i ka përcaktuar format e kontrollit të dijes në rregulloren bazë. Ndonëse respektohet liria akademike dhe autonomia institucionale e pedagogut, format e kontrollit të dijes rezultojnë të jenë gjithashtu bazuar në vizitën në institucion edhe transparente. Nota përfundimtare përbëhet nga provimi gjysmë-final, aktivizimi në auditor, detyra e lëndës (ose projekte) apo edhe forma të tjera. Kjo nuk është e unifikuar për çdo lëndë. Studentët njihen me format e kontrollit të dijeve që në fillim të semestrit. Testimet zhvillohen me shkrim dhe të sekretuara. (Tabela nr. 15 në Aneks)

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët aktivizohen në forma të ndryshme në aktivitetet e njësisë bazë, departamentit. Ata marrin pjesë në punën kërkimore të stafit akademik, si dhe nëpërmjet konferencave studentore. Gjithashtu një pjesë e tyre rezultojnë se ka publikuar edhe në revistat shkencore të departamentit (si "Zani i Naltë"). (Për një pasqyrë të detajuar të aktivizimit të studentëve, shih në Aneks, Tabela nr. 16).

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Institucioni ka zgjedhur të ketë një strategji më të kufizuar për pranimin e studentëve, duke përcaktuar kritere shtesë, përtej atyre të përcaktuar nga MASR (siç rezultojnë nga RVB dhe diskutimet me drejtuesit e institucionit (Përgjegjësën e Departamentit dhe Rektorin). Institucioni rezultojnë se ka procedurë të qarta të pranimit të studentëve, që njëkohësisht janë edhe transparente (përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve dhe fushatave, panaiereve, etj.), përfshirë edhe transparencën financiare publike të ofertës për programet. Cilësia e studentëve në hyrje është e lartë, duke llogaritur se gjatë të gjitha viteve të funksionimit, nota mesatare në hyrje ka qenë minimalisht 8.30 (për vitin 2015-2016) dhe nota mesatare maksimale 8.83 (për vitin akademik 2017-2018) (bazuar në RVB). Ndërkohë, rezultojnë se koha mesatare e zgjatjes së studimeve është afërsisht 3.5 vite. Kriteret e pranimit përbëhen nga mesatarja (si kriter ligjor) që përcakton 70% të vlerësimit të pranimit, intervista (nga komisioni i vlerësimit të departamentit përkatës) që përcakton 30% të vlerësimit dhe gjuha e huaj në nivel B1. Raporti student pedagog është 1 pedagog me 4 studentë. Punësimi i të diplomuarve gjatë periudhës 2013-2018 është i kënaqshëm, ku nga 125 të diplomuar (2013-2018) janë punësuar 61 (përfshirë profilin dhe jo në profilin e mbaruar), ndërsa pjesa e mbetur vazhdon

studimet në nivele të tjera. (këto të dhëna bazohen në RVB). *Ndërkohë universiteti është duke punuar për të ngritur dhe konsoliduar një rrjet Alumni (ish-studentësh të diplomuar), por mbetet më shumë për t'u bërë në këtë drejtim (siç rezultoi nga takimi me studentët dhe të diplomuarit nga programi i studimit).*

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Kriteret e pranimit përbëhen nga mesatarja (si kriter ligjor) që përcakton 70% të vlerësimit të pranimit, intervista (nga komisioni i vlerësimit i departamentit përkatës) që përcakton 30% të vlerësimit dhe gjuha e huaj në nivel B1. Numri i studentëve të pranuar bazohet në standardet dhe kriteret ligjore, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve për ciklin e parë të studimeve bëhet nga Komision Ad-Hoc i ngritur me propozim të Këshillit të Departamentit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela nr.17 në Aneks).

Në përgjithësi rezultojnë se studentët kanë ruajtur një tendencë të lehtë rritjeje nga hyrja në dalje të programit, me rritje të lehtë të mesatares së tyre vjetore.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Shih tabelën 17 në Aneks).

Rezultojnë nga tabelat në RVB se gjatë vitit akademik 2013-2014 janë regjistruar 34 studentë, në vitet pasardhëse 29, 22, 25, 11 dhe 15 (në vitin aktual, 2018-2019). Numri i studentëve ka ardhur në zbritje, dhe ky mund të konsiderohet një faktor që relativisht mund të ndikojë në funksionimin e programit (ndonëse kjo situatë duket se është e qëndrueshme në vlera mbi 10 studentë).

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare
Numri i studentëve të diplomuar në vitin e fundit (2017-2018) është 41. Nota mesatare 8.02

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sa i takon mobilitetin, institucioni ka ndërmarrë një sërë nismash, sidomos me universitetet e huaja. Megjithatë, brenda sistemit të arsimit të lartë shqiptar, mobiliteti është i kufizuar, për shkak të natyrës shumë specifike të këtij programi Bachelor. Gjithsej të transferuar që prej fillimit të funksionimit të këtij programi kanë qenë 8 studentë, të shpërndarë në vite, 2013-2019. Ndërsa mobiliteti ndërkombëtar ka zënë një vend të rëndësishëm, ku vlejnjë të përmenden shkollat verore në Austri dhe Egjipt, bashkëpunimet në formën e trajnimeve me universitetet e Kajros dhe El Ez'her në Egjipt, etj.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Punësueshmëria është në nivel të kënaqshëm. Nga 125 të diplomuar në total, janë punësuar 34 (në pozicione që lidhen me profilin e diplomës) dhe 27 në pozicione të tjera. Shkalla e punësueshmërisë është rreth 50%.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Procesi i pranimit të studentëve në programin e Bachelorit për Shkenca Islame është bërë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë (9741/2007) deri në 2015, ndërsa më pas me ligjin e ri për arsimin e lartë (80/2015).
Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë	Ka një harmonizim të kriterëve të pranimit me ato të legjislationit në fuqi, të cilave u janë shtuar edhe intervistat nga komisioni i posaçëm i vlerësimit me bazë departamenti

<p>mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>(mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70% dhe intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%) (Mbështetur në Rregulloren e Programit).</p> <p>Kriteret e propozuara nga institucioni rezultojnë transparente dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të institucionit (www.beder.edu.al).</p> <p>Institucioni rezulton gjithashtu se ndjek një politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara.</p> <p>Ai gjithashtu aplikon politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj (bazuar në RVB).</p>
<p>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga institucioni në mënyrë elektronike (përmes një aksesit të personalizuar) si dhe kanë një mentor akademik për çështjet mësimore. Siç rezultoi nga vizita në sekretari dhe takimet me stafin administrativ, studentët informohen gjithashtu nga sekretaria mësimore lidhur me organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve.</p> <p>Çdo semestër studentët kanë të drejtë të vlerësojnë pedagogët e lëndës. Këto vlerësime merren parasysh pasi përpunohen dhe mbi to shikohen mundësitë e përmirësimit nga ana e institucionit dhe stafit PAE dhe PAK. Gjatë intervistave me studentët të zhvilluara gjatë vizitës në institucion rezultuan raste kur këto janë marrë parasysh.</p> <p>Studentët kanë një sistem të plotë të këshillimit të karrierës nëpërmjet Drejtorisë së marrëdhënieve me studentin (siç rezultoi edhe nga takimi me përfaqësuesit e kësaj strukture). Ky sistem përfshin gjithashtu ndërtimin e CV-ve dhe përgatitje të tjera për tregun e punës. Gjithashtu ata kanë mundësi të kryejnë praktika mësimore në shumë institucione, përfshirë por jo vetëm Komunitetin Mysliman dhe Medresetë.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Statistikat e disponuara nga institucioni, të vendosura në dispozicion të GVJ-së janë të plota dhe të sakta. Ato përfshijnë statistikën vjetore të numrit të studentëve, mesatares së tyre, transferimet, ndërprerjen e studimeve dhe vitet akademike përkatëse. Gjithashtu janë ofruar nga institucioni edhe mesataret në hyrje dhe në dalje, sipas viteve. Vëzhgimi i regjistrave themeltarë ishte në përputhje me RVB-në, ndërsa institucioni pasqyron të dhëna të plota të ecurisë së studentëve të ciklit Bachelor.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre</p>	<p>Rezultoni se institucioni i ka kushtuar vëmendjen e duhur edhe</p>

dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

planifikimit të karrierës. Përveç Zyrës së Planifikimit të Karrierës, funksion në çdo departament Bordi i Këshillimit të Karrierës, me shtatë anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre. Ky bord u mundëson studentëve lidhjet e tyre me tregun e punës.

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, nga studimi i RVB dhe dokumenteve të tjera, si dhe takimeve në Departament, arriti në përfundimet e mëposhtme:

- a. Rezultoni se institucioni i ka kushtuar vëmendjen e duhur edhe planifikimit të karrierës.
- b. Statistikat e disponuara nga institucioni, të vendosura në dispozicion të GVJ-së janë të plota dhe të sakta.
